



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E GJILANIT  
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



---

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK  
DEPARTMENT OF ECONOMY DEVELOPMENT – UPRAVA ZA EKONOMSKI RAZVOJ - İKTİSADİ KALKINMA MÜDÜRLÜĞÜ

---

# ***RAPORT***

## ***janar – dhjetor 2015***

---

*Dhjetor ' 2015*

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë muajit janar – dhjetor 2015 ka vazhduar me aktivitete të cilat kanë ndikuar në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik lokal në komunë, e gjitha duke përkrahur biznese të vogla e të mesme që të aplikojnë në thirrjet për grante gjë që po rezulton sukses .

Gjatë kësaj periudhe fokus i veçantë i është kushtuar bashkëpunimit me komunitetin ndërkombëtar (donatorët) dhe Qeverinë e Kosovës (ministrit e linjës), po ashtu rëndësi të madhe i kemi kushtuar edhe bashkëpunimit me drejtoritë komunale .

***Gjatë muajit janar – dhjetor Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka kryer këto aktivitete :***

- Me kërkesë të Shëbimit të Kuvendit ka përgatitur dhe ju kemi dorëzuar grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2016 .
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik - Zyra për Eficencë të Energjisë e cila në bashkëpunim dhe në mbështetje të Asociacionit të Komunave të Kosovës kanë nënshkruar Marrëveshje të Mirëkuptimit për financimin e aktiviteteve në vlerën prej 40.000 € për implementimin e Strategjisë për Energji, programi EeMA (që financohet nga GIZ dhe SDC) .

Pas projektit të fituar muaj më parë për implementimin e efijencës së energjisë, përkatësisht për hartimin e SEAP, **Komuna e Gjilanit është pranuar në Konventën e kryetarëve të Komunave** në Bruksel.

Pranimin në këtë Konventë është nënshkruar nga kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, më 15 tetor 2015 në konferencën vjetore të BE-së për një Europë me energji të qëndrueshme.

- Është punuar ngusht me Njësin e Auditimit të Brendshëm në implementimin e rekomandimeve të dalura nga vitin 2014, po ashtu nga Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë muajit tetor – nëntor 2015 kemi pas auditim detal që sipas raportit që kemi pranuar kemi realizuar të gjitha rekomandimet dhe kemi dalur si drejtoria me suksesshme sa i parket respektimit të procedurave dhe ligjit .
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në saje të bashkëpunimit ka fuqizuar marrëdhëniet me Ministrinë e Financave të Kosovës dhe Ministrisë së Financave të Austrisë ku ka aplikuar në programin (Soft Loan Project) i cili program i dedikohet projekteve madhore që përfshin infrastrukturën publike me fokus të veqant rrjete të kanalizimit dhe trajtim të ujërave të zeza .
- Është punuar ngushtë me Agjensin për Zhvillim Rajonal (RDA) Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) dhe Ministrinë e Integritimit Evropian për organizimin e konferencës së donatorëve e cila është mbajtur me 4 mars ku 11 komuna të regjionit lindje ka paraqitur komunitetit ndërkombëtar projektet e tyre, konferenca është mbështetur nga zyra e BE-së në Kosovës .

- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik po e njofton dhe po e ndihmon komitetin e biznesit, grupet e nxënësve dhe studentëve, organizat e shoqërisë civile si dhe grupet tjera të interesit për aplikim në programet për grante të cilat po afrohen nga organizatat ndërkombëtare , gjatë viti 2015 kemi bashkëpunuar me këto organizata ndërkombëtare të cilat janë duke i realizuar këto programe :

- a) Programi Community Development Fund, partner implementues i programit të USAID-it "Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale në Kosovë i cili i dedikohet punësimit dhe zhvillimit ekonomik .

USAID programi AKT (Avancojmë Kosovën së Bashku) në saje të bashkëpunimit të mirë kemi realizuar dhe janë në fazën e realizmit dhe tenderimit këto projekte :

1. Pastrimi i shtratit te lumit ne fshatin Kmetovc
2. Ndertimi IP në lagjen "Dardania",
3. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Livoq i Epërm ,

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik është duke punuar me Organizantën Qeveritare USAID/AKT ne mundesin e mbështetjes se Hartimit të Planit për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal .

Edhe gjatë vitit 2016 USAIDi do të jetë njëri ndër parterët më të fuqishëm dhe më të besueshëm ne mbështetjen e programeve dhe projekteve tona.

- b) Programin Empower Sektori Privat që financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Cardno Emerging Markets USA, Ltd. (Cardno). EMPOWER Sektori Privat bashkë me Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë dhe Komunën e Gjilanit kanë siguruar një hapësirë të shkëlqyeshme në panair për kompanitë kosovare.

USAID programi Empower ka përkrahur (8) tetë biznese, prej tyre (3) tre janë nga Komuna e Gjilanit (Menakon, Qendresa dhe Minna) Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka mbështetur aktivitet e tyre për pjesmarrje ne panairin e modës e cila është mbajtur në Shqipëri (Tiranë)

- c) Programi i Vetëpunësimit - Ky program do të implementohet me mbështetjen e projektit të UNDP Programet Aktive të Tregut të Punës 2, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës, UNDP dhe Qeveria e Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale) komuna partnere të këtij programi janë : Gjilani, Prishtina dhe Prizreni.
- d) Programi KYDP (Kosovo Youth Development Projekct) - Projekti për Zhvillimin e Rinisë në Kosovë i cili ofron trajnim falas për ndërmarrësit e rinj. Projekti është financuar nga Banka Botërore dhe ka për qëllim përkrahjen e të rinjëve në biznes nëpërmes trajnimeve dhe granteve. Projekti financohet nga Banka Botrore dhe implementohet nga organizata "Qendra Rinore" Gjilan, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka siguruar shtatë (7) zyre brenda hapësirës së Inkubatorit të Biznesit
- e) PPSE (Promoting Privte Sector Employment) – sektorët në të cilët do të mbështetën nga ky janë : Sektori i turizmit dhe Përpunimit të ushqimit.

Fondi i mundësive është mekanizëm grantesh në përkrahje të krijimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të punësimit në sektorin privat për të rinjtë .

Do të përkrah financiarisht konceptet e projekteve nga 10.000 € minimum e deri në 100.000 € maximum, aplikuesit duhet të sigurojnë fondet vetanake nga 20-50% të vlerës totale të projektit.

- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik është duke bashkëpunuar ngushtë edhe me organizatën GIZ dhe në Hartimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave e cila strategji do të miratohet nga Asambleja Komunale gjatë muajit janar 2016, po ashtu në kuadër të aktiviteteve kemi aplikuar edhe me projekte të cilat e ndimojnë sektorin e trajtimit të mbeturinave :
  - a) Pilot Projekti “Gjilani Riciklon” ku përfshihet trajnimi i mbeturinave në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të qytetit dhe institucionet komunale projekti implementohet nga organizata Green Art Ceneter – Prishtina .
  - b) Pilot projekti “Dardania” e cila përfshin trajtimin dhe ndarjen e mbeturinave, tani kemi marrëveshje me kompania “Schafer” që ka shprehur gatishmëri që ta implementoj këtë pilot projekt, ku do të financoj konteinerë të kapacitetit 240 litra për lagjen “Dardania” dhe të kapacitetit 1.1 m3, që kapin vlerën e afro 50 mijë eurosh, derisa Komuna participon me shumën prej 5 mijë eurosh.
- Po ashtu nuk ka munguar edhe bashkëpunimi me TIK-në Turke e cila ka aprovuar projektin që është dorëzuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik që ka të bëjë me furnizimin e 155 bletarëve të Komunës së Gjilanit me rroba dhe paisje tjetër për bletarë si dhe paisjen e 40 fermerëve me mekanizëm bujqësor (shpërndarëse gruri)
- Po ashtu dy programet e Komisionit Evropian tani më janë kompletuar me staf dhe janë në fazën intenzive të realizmit – fjala është për programet :
  - Programi BE – BNK Bashkëpunimi Ndërkufitarë Komuna e Gjilanit (KS) & Komuna e Çairit (MK) e cila implementohet edhe në bashkëpunim me dy organizata jo qeveritare Organizata AgorEko (Gjilan) dhe Iniciative for European Perspective (Çairë), emri i projektit : Valorizimi i tregtisë tradicionale dhe potenciali socioekonomik  
Programi BNK ka shpallur thirrjen për grante të vogla të dedikuara bizneseve të vogla dhe të mesme, ku do të shpërndahen 20 grante në vlerë prej 2000 €, përmes këtij projekti po ruhet tradita e zejeve tradicionale dhe po ndikohet në zhvillimin socioekonomik.
  - Programi BE – EURED, emri i programit : Zhvillimi i Agrobizneseve në Regjionin e Gjilanit, që po realizohet nga Organizata CARE dhe ATRC . Programi ka mbështetur fermerët me sera si dhe ka nxitur bujqit dhe ka ndihmuar në kultivimin e sallates, bimeve mjeksore - aromatike në sera dhe fushë të hapurë si dhe ka ndare pasije (tharëse për bimë mjeksore – aromatike), po ashtu program ka nxitur dhe ka ndihmuar edhe nxënësit dhe studentet e komunes së Gjilanit (100) prej tyre të cilët janë të angazhaur në punë praktike (3) mujore neper biznese dhe kompani private .
  - Programi Kosova e Bukur faza II / EU-BEAUTIFUL KOSOVO PROGRAMME (EU-BK II) ku është aprovuar projekti Ndërtimi i parkut të qytetit në lagjen “Dardania” i cili është në realizim e

sipër dhe pritjet të përfundoj gjatë muajit dhjetor 2015, në Lagjen "Dardania" është investimi më i madh i cili po ndodhë që nga pasë lufta .

- Help – Hilfe zur Selbsthilfe E.V – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka aplikuar dhe është aprovuar projekti "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro-bizneseve në Kosovë" i cili do të bashkë-financohet në bashkëpunim me Organizata Help, projekti do të filloj të zbatohet në muajin janar 2016 dhe të përfundoj ne Dhjetor 2016 ku do te shpërndahen 40 grante ne komunën tonë ndërsa Marrëveshja e bashkëpunimit do të nëshkruhet gjatë muajit tetor 2015
- KfW (Bankën Gjermane për Zhvillim) – është e fokusuar në projektet të cilat kanë të bëjnë me Eficiencën e Energjisë kryesisht në ndërtesa publike .
- Programi : Mbështetje për Ndërmarrjet Mikro të Vogla dhe Mesme në Kosovë (Grante për NVMtë) - Programi financohet bashkërisht nga Bashkimi Evropian, përmes Zyrës Ndërlidhëse në Kosovë dhe Ministria e Tregtisë e Industrisë (MTI) ndërsa implementohet përmes zyrës së organizatës IOM – zyra në Kosovë .  
Përmes Zyrës për promovimin e investimeve, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, i ka inkurajuar bizneset që të shfrytëzojnë këtë mundësi për të aplikuar dhe përfituar grante, duke ofruar për ta gjithë ndihmën e nevojshme të kësaj drejtorie duke organizuar dy takime informuese per komunitetin e biznesit .

Nga Programi : Mbështetje për Ndërmarrjet Mikro të Vogla dhe Mesme në Kosovë (Grante për NVM-të)  
Përfituesë janë dy bizneset:

1. "Festa" rrobaqepësen cila bënë prodhimin e veshjeve për femra dhe
2. "Gan Dizajn", që merret me dizajne të ndryshme, gravim, shtyp dhe produkte të tjera të llojllojshme

Qëllim i programit është të kontribojë në forcimin e ekonomisë lokale, duke përmirësuar kapacitetet e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, për të prodhuar në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme, në përputhje me standardet dhe praktikat evropiane.

Progrmet : Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA) kemi tri ( 3) projekte :

- Emri i projektit : Ndërtimi i objektit të shkollës fillore "Bajram Curri" në fshatin Shurdhan
- Qëllimi i projektit : shkolla fillore "Bajram Curri" në fshatin Shurdhan – është njëra ndër shkollat me moderne si për nga kapaciteti dhe cilësia e cila do ti shërbej 150 nxënësve te Malësis së Shurdhanit
- Publication reference EuropeAid/132396/C/WKS/XK,
- Punëkryesë : AlTrade – Prishtinë

Projekti ka këto karakteristika :

- i. Emri i projektit : Ndërtimi i fushës së futbollit – stadioni ndimës mbi palestren e sporteve
- ii. Punëkryes : Hidroterm – Suharekë,
- iii. Projekti pritjet të përfundoj gjatë muajit maj/qershor 2016

Projekti ka këto karakteristika :

- iv. Emri i projektit : Ndërtimi i Bibliotekës Rajonale

Zyra e Komisionit Evropian per shume kohe ka pezulluar punimet në këtë projekt, pjese e kësaj pako te tenderimit dhe pezullimit të punimeve kanë qenë edhe disa projekte të ngjashme në komunat : Podujevë, Mitrovicë, Obliq, Fushë Kosovë dhe Vushtrri.

Pas një shkrese (kërkese) të përgatitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik përmes Zyrës së kryetarit për Zyrën e Komisionit Evropian pas një procedure të gjatë të ritenderimti, përzgjedhjes dhe kontraktimit gjatë muajit dhjetor 2015 ka filluar realizimi i projektit i cili pritet të përfudnij nga fundi i vitit 2016 .

Programi Cultural Heritage Without Borders (ChwB) : Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik edhe gjatë vitit 2015 ka koordinuar aktivitetet me këtë organizatë e cila është duke implementuar strategjinë “Planet Lokale të Trashëgimisë Kulturore ” pjesë e së cilës është komuna e Gjilanit .

Komuna e Gjilanit ka përcaktuar nevojën e investimit nga kjo organizatë e cila po bashkëfinancohet projektin

:

- Ndërtimi i urës afër kalasë së fshatit Pogragjë ,
- Vlera e projektit : 89.241.30

Projekti Ndërtimi i urës afër kalasë së fshatit Pogragjë pritet të finalizohet gjatë fillimit të vitit 2016, për të hapur rrugë projektve dhe aktiviteteve tjera me këtë projekt .

Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QRB) në Gjiilan gjatë periudhës janar – dhjetor 2015 ka kryer aktivitetet e saja sa i përket kërkesave të qytetarëve për regjistrim të bizneseve dhe komunitetit të biznesit për ndërrim dhe shtim të aktiviteteve biznesore apo edhe shuarje të biznesit .

Bazuar në të dhënat nga Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QRB)

Numri i bizneseve të regjistruara : 485

Numri i bizneseve femra : 92

Numri i bizneseve meshkuj : 393

Numri i punëtorëve të deklaruar : 790

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka pas një bashkëpunim të mirë me Zyrën e Punësimit në Gjiilan që është në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale, sa i përket sektorit të punësimit për periudhën janar – nëntor 2015 kemi këto të dhëna :

Numri i të punësuarve në sektori publik : 68

Numri i të punësuarve në sektori publik : 371

Rekapitullim :

Numri i përgjithshëm i të punësuarëve në vitin 2015 është :

Numri i të punësuarve në sektori publik : 68

Numri i të punësuarve në sektori publik : 1161

Totali : 1229

- Sektori i Inspeksionit gjatë periudhës janar – shtator ka inspektuar bizneset që nuk janë të regjistruara, po ashtu ka njoftuar komunitetin e biznesit për rregulloret komunale (orari i punës) dhe (taksa komunale) .
- Zyra për financa - po kryen aktivitetet e saja e cila falë angazhimit kemi arritur të implementojmë Rregulloret Komunale (Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale) . Zyra për financa po përcjell dhe po koordinohet në aktivitetet të përditëshme dhe me Drejtorin e Buxhetit dhe Financave ku po përcillen projektet kapitale, ato të mallrave dhe shërbimeve si dhe komunalit .

***Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka kryer edhe këto aktivitete sa i përket panairove :***

- Në bashkëpunim me Agjensin për Zhvillim Rajonal (RDA) është organizuar edhe panairi Rajonal Pranveror i cili është mbajtur më datën 30 prill .
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka marrë pjesë edhe në panairin e Cyrihut i cili është dedikuar projekteve madhore ne infrastrukturë dhe krijimin e vendeve te lira te punës, panair është mbajtur nga data 19-21 maj të vitit 2015 . Komuna e Gjilanit në panairin ndërkombëtar "Investment Management Exhibition" kamarrë çmimin “The best City Model Award” nga IME.
- Panairi Regjional “Gjilani 2015” – i cili do të mbahet me datë 2,3 dhe 4 korrik, ku kanë marrë pjesë afërsisht 100 biznese, të regjionit Lindje. Panairi Regjional “Gjilani 2015” ka shërbyer si mundësi për promovimin e prodhimeve lokale në nivel regjional, ky aktivitet do të jete një rast i mire ne këmbimin e përvojave dhe te promovimit te brendeve lokale ne nivel regjional si dhe tek bashkatdhetarët tanë qe ne këtë periudhe kohore gjenden për pushime .
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik pas Panairit Regjional “Gjilani 2015” ka organizuar edhe aktivitetin e radhës “Ditët e Mërgatës” i cili është mbajtur me 30, 31 korrik dhe 1 gusht 2015, po shtu gjatë kësaj kohe janë orgnziauar edhe aktivitet të shumta për nderë të mërgatës si dhe aktivitet të shumta “Ditët e Vendeve Mike” si dita e Japonisë, Amerikës, Gjermanisë dhe Austrisë, ...
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik është duke koordinuar aktivitet edhe me Organizatën Qeveritare Gjermane Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – GIZ, e cila po fillon implementimin e projektin “Promovimi dhe konkurrentshmëri se sektorit privat në zonat rurale - COSiRA” të financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik -BMZ. Projekti i GIZ COSiRA " Konkurrueshmëria e sektorit privat në zonat rurale ", përfshin institucionet private dhe publike në nivel lokal në identifikimin e avantazheve krahasuese rajonale.  
Projekti "Konkurrueshmëria e Sektorit Privat në zonat rurale në Kosovë (COSiRA)", pritet të implementohet gjatë vitit 2016

***Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka kryer edhe keto aktivitet të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e bashkëpunimit me akteret të cilët ndikojnë në Zhvillimin Ekonomik Lokla :***

- Pjesëmarrja në takimet e Komitetit Drejtues të Projektit për Bashkëpunimi Ndërkufitar – Në këtë takim jam informuar për komponentet e projektit dhe kam marrë përgjegjësi që ti kordinojmë punët me task menaxheren në menyre që ti shtyejmë punët për ta realizuar projektin me kohë.
- Partneriteti Publiko Privat : Projektit “Kompleksi i shkollave të mesme” i cili pritet të implementohet gjatë vitit 2016 pasi të gjitha procedurat janë përfunduar .

Tani jemi në fazën për përgatitje e raportit të fizibilitetit për projektet :

- a) Palestra sportive “Bashkim Selishta” dhe
- b) Objektet përcjellëse (stalla e lopëve, sera, plantacioni, depoja ftohëse për pemë dhe perime) të shkollës së mesme bujqësore “Arbëria..



- Në vazhden e aktiviteteve të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik jemi takuar edhe me përfaqësuesin e “D&D – Business Support Center”, të cilët janë duke e implementuar projektin e Bankës Botërore për Zhvillimin e Rinisë në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij projekti është përmirësimi i mundësive ekonomike dhe qasja e qëndrueshme në shërbime për të rinjtë e Kosovës por edhe promovimi i kohezionit social si dhe bashkëpunimi shumë etnik midis të rinjve, e sidomos për grupet e anashkaluara dhe të pambrojtura.
- Kemi vizituar objektin e inkubatorit të biznesit ku jemi informuar me gjendjen reale të objektit me qëllim të funksionalizimit për destinacionin e caktuar – ku do të kthehet komuniteti të biznesit, intezivisht e kemi duke punuar në këtë drejtim ku kërkuar nga kompania publike “Hidromorava” lejin e zyreve për Agjencinë e Pyjeve dhe AVUK-ut me qëllim të largimit për të liruar zyrat e inkubatori të biznesit.
- Drejtorja e Zhvillimit ekonomik ka krijuar ura bashkëpunimi edhe me përfaqësuesit e Odës Ekonomike Gjermano - Kosovare , qëllimi i takimit ishte bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve të përbashkëta të cilat do të ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Komunës së Gjilanit.
- Takim me investitor të mundshëm: znj. Claudia Kirchhoff z. Uwe Voelung dhe Gëzim Kurteshi – së bashku me Drejtorin e Bujqësisë z. Ramiz Ramadani, jemi takuar me dy investitorë të cilët kërkojnë që të hulumtojnë tregun për investime kryesisht në sektorin e qumështit, majmërimit të viçave dhe kultivimin e peshkut.
- Në bashkëpunim me organizuatën nga Global Consulting dhe Development Associates, në mbështetje të Komunës së Gjilanit dhe UNDP, e cila është financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim, ku ka mbledhur bizneset e ndryshme nga Gjilani, Dragashi dhe Shtërpa, i cili është i pari i kësaj natyre (B2B) , me qëllimin e bashkëpunimit dhe takimit edhe fizik të përfaqësuesve të bizneseve për zhvillim të mëtutjeshëm të tyre.
- Takim shefin e misionit të zyrës ndërlidhëse në Kosovë, Lubomir Batary, gjatë takimit është diskutuar për bashkëpunimin ekonomik mes bizneseve gjilane dhe atyre sllovaqe (B2B) duke thekuar se Gjilani është qyteti me mundësitë më të mira për të bërë biznes.

#### ***Përfundim :***

Drejtorja për Zhvillim Ekonomik gjatë muajit dhjetor 2015 në koordinim me Zyrën e kryetarit ka përgatitur projektet dhe ka aplikuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në Programin Komunal për Zhvillim të Infrastrukturës i cili program bashkëfinancohet nga Komisionin Evropian (KE) me këto projekte :

- a) Rekonstruimi i rrugës “Adem Jashari” dhe “Zija Shemsiu” Gjilan,
- b) Ndërtimi i infrastrukturës të zonës së përbashkët ekonomike (Gjilan dhe Novobërdë) në fshatin Llabajn,
- c) Salla sportive - shkolla fillore dhe e mesme “Vuk Karaxhiqi” fshatin Shillovë

E ardhmja e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për vitin 2016 do të përqendrohet në sensibilizimin e ekonomisë dhe kapaciteteve që ka Gjilani e Anamorava. Do të fokusohemi për të pasur një pasqyrë të saktë të të gjitha bizneseve ekzistuese, fuqinë e tyre punëtore, prodhimtarinë e tyre në mënyrë që të jemi më afër problemeve të tyre.